

fëmijët filluan të ikin me vrap nga oborri. Policët e njohën Nazmiun, të cilin e ëma e kishte veshur me rroba të grave. E rrëzuan në tokë dhe, në prani të të gjithëve, e qëlluan me plumba në zverk dhe në shpinë. Përderisa ikte me vrap nga shtëpia, Beqirin e kanë plagosur në këmbë dhe stomak. Ka ndërruar jetë pas disa orësh. Qazimi, Beqiri, Halili dhe Nazmiu u varrosën më 11.03.1998, së bashku me të gjitha viktimat e tjerë, në varrezat në *Mëhallën Jashari*.

Burimet: deklarata S.J, FDH-20314; deklarata S.J, FDH-20312; deklarata V.J, FDH-20316; deklarata P.J, FDH-31873; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 17-18, 130-131, FDH-23807; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oruz-anih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; Bardhyl Hamzaj i Faik Hoti, *Jasharet*, Zerri, 2003, FDH-36789; FHP, penale (Radoslav Mitrović dhe të tjerë), 2.03.2009, FDH-36787.

Mihrije (Feriz Shala) Jashari

(5.12.1942, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, trembëdhjetë fëmijë)

Sabrije (Zymer) Jashari

(1976, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise)

Hanife (Zymer) Jashari

(1981, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise)

Kur forcat speciale policore kanë hyrë në mëngjesin e datës **5.03.1998** në *Mëhallën Jashari* [**Prekaz i Poshtëm/Donje Prekaze**], Hajzeri dhe Murtezi kaluan te axha i tyre Haliti [të shikohet regjistrimi në vijim], ndërkaq Mihrija, Sabrija dhe Hanifja kanë mbetur në shtëpi. Pas tërheqjes së forcave serbe nga fshati, banorët e kanë gjetur shtëpinë të rrënuar në tërësi. Familjarët nuk kanë njohuri as sot e kësaj dite për fatin e Mihrijes, Sabrijes dhe Hanifes dhe as që dihet çfarë ka ndodhur me trupat e tyre. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Mihrijes është regjistruar me numër BLG-805041-01, i Sabrijes me BLG-805041-03, ndërkaq ai i Hanifes më BLG-805041-02.

Burimet: deklarata V.J, FDH-20309; deklarata H.J, FDH-20307; deklarata V.J, FDH-18178; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 17-18, 130-131, FDH-23807; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oruz-anih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; SHFĐUÇK, *Feniksët...*, 9, 41-43, 68-70, 109-111; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; FHP, penale (Radoslav Mitrović dhe të tjerë), 2.03.2009, FDH-36787.

Halit (Imer) Jashari

(15.09.1934, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, tetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Elheme (Ukshin Gashi) Jashari

(18.08.1938, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, tetë fëmijë)

Hajzer (Zymer) Jashari

(15.04.1969, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, tregtar, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Murtez (Zymer) Jashari

(5.03.1979, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Bahtije (Muharrem Dobra)

Jashari

(8.10.1953, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, shtatë fëmijë)

Avdullah (Zenë) Jashari

(27.05.1982, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës, pjesëtar i UÇK-së)

Bujar (Zenë) Jashari

(10.10.1987, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës)

Blerim (Zenë) Jashari

(12.12.1992, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës.)

Në mëngjes, më 5.03.1998, pas hyrjes së forcave policore serbe në **Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze**, te Halit Jashari kanë ardhur i afërmi i tij Zenë Jashari me familje dhe djemtë e vëllait të tij, Hajzeri